



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr- 410-28565

Më datë 02.05.2023

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58, të Ligjit Nr-03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e në mbështetje të nenit 5 të Rregullores (MAPL) Nr. 01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës, e konform nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, Kryetari i Komunës së Suharekës, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit

1. Formohet komisioni për hartimin e projekt-Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve, 01-Nr-16-586 të datës 30.01.2013, në këtë përbërje:
 - 1.1 Avni BYTYÇI-----kryesues
 - 1.2 Lorika GASHI-----anëtare
 - 1.3 Suada BERISHA-----anëtare
2. Detyrë e komisionit është që ta hartojnë projekt-Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve, 01-Nr-16-586 të datës 30.01.2013 dhe ti rekomandojnë Kryetarit të Komunës për vazhdim të procedurave të mëtutjeshme.
3. Në mbështetje të nenit 7, paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr. 07/2023 për kompensimin për kujdestari, punën gjatë natës dhe punën jashtë orarit të punës, **AUTORIZOHET**-komisioni i lartë cekur që të punojnë jashtë orarit të punës dhe ditëve të vikendit për hartimin e projekt- Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve, 01-Nr-16-586 të datës 30.01.2013.
4. Komisioni për punën jashtë orarit të punës do të kompozohet konform nenit 7 lidhur me nenin 8 të Rregullores (QRK) Nr. 07/2023 për kompensimin për kujdestari, punën gjatë natës dhe punën jashtë orarit të punës, sipas Ligjit dhe akteve tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës që e rregullojnë këtë çështje.
5. Ky aktvendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Kryetari i Komunës
Bali MUHARREMAJ

Të njoftohen;
Anëtarët e komisionit
Evidenca